

# Rubella

Fakte të rëndësishme për të gjithë, veçanërisht për femrat që kanë arritur moshën e pjekurisë



FAKTE TE RENDESISHME PER TE GJITHE NE SHOQERI

## Kush nuk duhet të marrë “MMR”?

- Personat që kanë alergji prej antibiotikut neomicin.
- Femrat shtatzanë ose ato që planifikojnë të mbeten shtatzanë brenda një muaji pas vaksinimit.
- Personat me sëmundje, ose që kurohen me barna, që ulin sistemin e imunitetit si kortizon apo prednisolon.
- Personat që vuajnë nga infeksione akute.

## Për më shumë informacion

- Bisedoni me doktorin tuaj.
- Pyetni pranë zyrës shëndetësore të qeverisë suaj lokale.
- Pyetni maminë e konsultores për foshnjat.
- Pyetni pranë klinikës së Planifikimit Familjar.
- Seksioni i Vaksinimeve, Qeveria e Shtetit të Viktorias  
Telefoni 1300 882 008  
Ose në faqen e internetit [www.health.vic.gov.au/immunisation](http://www.health.vic.gov.au/immunisation)
- Edukimi i Rubeolës Infermierja, Fondacioni i të Shurdhëve  
Telefoni (03) 9887 8683  
Email [rubella@deafness.org.au](mailto:rubella@deafness.org.au)  
Faqja e internetit [www.deafness.org.au](http://www.deafness.org.au)

## Përkthimet në disa gjuhë

Ky pamflet është përkthyer në disa gjuhë prej Fondacionit të të Shurdhëve. Ju mund të merrni më shumë informacion në gjuhën tuaj duke i telefonuar falas Shërbimit të Përkthimeve (TIS) në 13 1450.

## Rubella



**Deafness Foundation**

Published by  
DEAFNESS FOUNDATION  
(VICTORIA)  
P.O. Box 42, Nunawading 3131.  
Telephone (03) 9887 8683 Fax (03) 9887 8848  
E.mail [rubella@deafness.org.au](mailto:rubella@deafness.org.au)  
Web site [www.deafness.org.au](http://www.deafness.org.au)

Publication sponsored as a community service by:



Endorsed by Immunisation Unit,  
State Government of Victoria

February 2005  
Project CSLV 2100.5.00

# Rubella

## Çfarë është Rubeola

Rubeola (ose e quajtur ndryshe Fruthi Gjerman) është një sëmundje ngjitëse me origjinë virale që zakonisht infekton fëmijët, por nganjëherë gjendet edhe tek adoleshentët dhe të rriturit. Ka raste që kjo sëmundje nuk paraqet simptoma por në shumicën e rasteve mund të shfaqet me ethe të lehta, enjtje të gjendrave, dhimbje kyçesh dhe skuqje të fytyrës ose të lëkurës së qafës. Skuqja zgjat rreth dy ose tre ditë. Shërimi është gjithnjë i shpejtë dhe i plotë.

Sëmundja e Rubeolës është shumë e rrezikshme gjatë 20 javëve të para të shtatzanisë. Në këto raste fëmija mund të lindë me shurdhësi, verbëri, defekte në zemër dhe paaftësi mendore. Kjo sëmundje njihet me emrin Sëmundja e Rubeolës së Lindur (SRL).

## Si përhapet Rubeola?

Rubeola përhapet si gripi dhe merret me anë të kollës dhe teshtimave të një personi të infektuar. Simptomat zakonisht shfaqen pas rreth dy javësh dhe shumica e njerëzve shpesh nuk e dinë se janë të sëmurë. Gjatë kësaj kohe ata mund të infektojnë persona të tjerë duke përfshirë këtu edhe gratë që ndodhen në javët e para të shtatzanisë, të cilat nuk kanë imunitet. Fëmija i palindur është më shumë në rrezik gjatë fazës së hershme të shtatzanisë.

## Kush sëmuret me Rubeolë?

Çdokush mund të sëmuret në se nuk është sëmurur më parë prej saj, në se nuk ka bërë vaksinën ose në se për një arsye apo tjetrën nuk ka imunitetin e duhur. Vaksinimi zakonisht jep mbrojtjen e duhur por 5-10% e të vaksinuarve mund të infektohen me Rubeolë sepse nuk kanë numrin e duhur të kundërtrupthave.

## Si mund t'a parandalojmë Rubeolën e Lindur?

**SRL dhe Rubeola mund të parandalohet!** Mënyra më e sigurt për të parandaluar anomalitë e lindura është që të merren të gjitha masat që femrat të vaksinohen kundër Rubeolës PËRPARA shtatzanisë. Shtatzania nuk rekomandohet për të paktën një muaj pas vaksinimit dhe gratë shtatzana nuk duhet të vaksinohen deri PAS lindjes së fëmijës. Vaksinimi i të gjithë fëmijëve dhe grave të pavaksinuara parandalon përhapjen e kësaj sëmundjeje tek të tjerët.

Në Australi rekomandohet që të gjithë fëmijët të vaksinohen me dy doza vaksine të "MMR" (Fruthi, Shytat dhe Rubeola). Njëra jepet në moshën 12 muajshe dhe e dyta në moshën 4 vjeçare. Kjo i parandalon të treja sëmundjet.

Të gjithë personat e lindur gjatë ose pas vitit 1966 duhet të kontrollojnë statusin e vaksinimit të tyre për t'u siguruar që i kanë marrë të dyja dozat e vaksinës "MMR". Këta persona rrezikojnë infektimin e vetes dhe të personave të tjerë. Ata inkurajohen të vaksinohen për të mbrojtur veten dhe të tjerët.

PËRPARA ÇDO shtatzanie, ka shumë rëndësi që femra të ketë imunitetin e duhur ndaj Rubeolës. Kjo kontrollohet me anë të një analize gjaku. Në se imuniteti mungon ose është i ulët atëherë "MMR" ose vaksina e Rubeolës duhet të përsëritet. Analiza e gjakut përsëritet pas 6-8 javësh për t'u siguruar që vaksina ka dhënë mbrojtjen e duhur.

## Kush ndodhet më shumë në rrezik?

Personat e lindur në ato vende ku vaksinimi i foshnjave nuk përmban rubeolën, mund të kenë nevojë të vaksinohen kundër kësaj sëmundjeje sidomos në se janë mbi moshën 4 vjeçare në kohën kur mbërrijnë në Australi. Veçanërisht, femrat e lindura në Azi apo në Afrikë duhet të vaksinohen kundër rubeolës përpara shtatzanisë sepse shumë prej tyre nuk janë të mbrojtura.

INFEKTIMI ME RUBEOLË GJATË FËMIJËRISË OSE MË PAS NUK GARANTON MBROJTJEN NDAJ RUBEOLËS. PËRPARA ÇDO SHTATZANIE REKOMANDOHET NJË ANALIZË GJAKU PËR TË PARË NIVELIN E IMUNITETIT.

## Ku merret vaksina?

Vaksina "MMR" mund të merret tek doktori familjes, klinika e planifikimit familjar, poliklinika lokale dhe tek shërbimi i vaksinimit të qeverisë lokale.

## Reaksionet-Ndërlikimet

Reaksionet prej vaksinës "MMR" janë më pak të rëndësishme se ndërlikimet e infeksioneve të rubeolës gjatë shtatzanisë. Reaksionet më të zakonshme janë të ndiherit të sëmurë, ethet e ulëta dhe nganjëherë skuqje pas gjashtë deri njëmbëdhjetë ditësh pas vaksinimit. Personat e vaksinuar nuk mund të infektojnë të tjerët. Në rastet e rralla të reaksioneve serioze mund të shfaqet inflamacioni i trurit, por këto raste ndodhin një herë në një milion doza ose më rrallë. Ju mund të bisedoni me doktorin për rreziqet dhe dobitë e vaksinimit.